

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ministrja kopjace"/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë
ADRESA	https://piranjat.al/investigime/ministrja-kopjace-klodiana-spahiu-ne-krye-te-shendetesis-e-punimi-i-d-i104921
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 19:28:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 19:26:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c62cadf538246a5a6a05e0e86503c82e5193330e903481783040ce3aada7ae34
TEKSTI	a2a34160557003d13c3650061546e0fce86cbfd30570b010fefe284a0324a7bf
PAMJA	5c13b1f142a0426c4362e5c7a68d47385a38fc652b32d22647235eb2c3a11bb4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8fdb1169a10ad5351f412797797bb2e9cdd042085ed7ca239e161472a74f085b
E MËPARSHMJA	8ab9c6675a0764625e626ce9245c133d6d41494a304b36c943ff72edb9f367eb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8fdb1169a10ad5351f412797797bb2e9cdd042085ed7ca239e161472a74f085b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

Hage, as
në
Beograd

edhe për
trajtimin e

diplomës
rezulton

i një brezi
që nuk ju

qeverisë/
Revolta

ten
36

INVESTIGIME

“Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 21:26



Të mërkurën e 2 shtatorit 2026, zonja Evis Sala dha dorëheqjen nga posti i ministres së Shëndetësisë. E cilësuar si ministrja e Shëndetësisë më jetëshkurtër në 4 mandatet e qeverisë Rama, Sala u largua me pretekstin se do të vijojë projektet e saj akademike. Posti i Ministres së Shëndetësisë iu besua deputetes së qarkut të Durrësit, Klodiana Spahiu.

Pas propozimit të kryeministrit, të martën e 8 shtatorit Kuvendi votoi me 79 vota pro dekretin e Presidentit Bajram Begaj për emërimin e Klodiana Spahiut si ministre e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit nuk i fshehu dot emocionet.

Ndërkaq, pas betimit të Presidentit më datë 11 shtator, zonja Spahiu mbërriti në Ministrinë e Shëndetësisë për ceremoninë e prezantimit me stafin dhe aty u përball me gazetarin Freard Rista, i cili e pyeti: *Si do ta drejtoni Shëndetësinë shqiptare kur e keni punimin e diplomës plagjiaturë?*

Ministrja më e re premtoi çudira në këtë sektor, duke këshilluar gazetarin që të bëhet njeri më i mirë.

Përtej këshillës, duhet të sqarojmë publikun lidhur me plagjiaturën e ministres Spahiu, denoncuar më herët nga studiuesi Taulant Muka. Paragrafi hyrës i punimit të ministres Klodiana Spahiu mban vitin 2018 dhe flet për ngarkesat e ventrikulit të majtë të pacientët me diabet të tipit 2 dhe vendi i studimit është Spitali i Durrësit.

Por zonja Spahiu nuk e ka shkruar vetë këtë paragraf, pasi e ka marrë fjalë për fjalë nga punimi i dy doktorëve koreanë, WangSoo Lee dhe Jaetaek Kim, punim i vitit 2017 për kardiomiopatinë diabetike.

“Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një person që ka mashtruar, ka falsifikuar dhe ka marrë diçka që nuk është e vetja dhe e ka përvetësuar si të vetën dhe ministrja nuk reagon. Nga ana etike, në radhë të parë kemi një problem, sepse po bën realitet që është diku tjetër, realitet që ti nuk e ke vërtetuar, nuk e ke prekur apo nuk e ke studiuar”, shprehet studiuesi Muka, i cili thekson faktin se kjo praktikë na kushton shumë si popull dhe si shtet.

Nëse flasim ende për pjesën e prezantimit të punimit shkencor, vëmë re se zonja Spahiu, pasi mbaroi punë me dy kolegët e parë, *lirisht merr sërish copy-paste dy paragrafë nga mjeku serb Brane Loncarevic.*

Ky i fundit, teksa trajton problematikën e kardiomiopatisë diabetike asimptomatike në praktikën e përditshme, citon ndër të tjera se *“asnjë nga pacientët tanë me diabet nuk kishte hipertrofi të ventrikulit të majtë, masa e ventrikulit të majtë dhe indeksi i masës së ventrikulit të majtë ishin të rritura krahasuar me pacientët e kontrollit të përputhur”.*

Mos harrojmë se këta individë, mbi të cilët është bërë studimi, janë pacientë të mjekut serb, të cilët me një “copy-paste”, zonja ministre i ka bërë pacientë të spitalit të Durrësit.


Por nuk është mjaftuar me kaq, pasi nga Serbia zonja Spahiu ka kaluar në Greqi, duke vendosur fjalë për fjalë një copë të punimit të vitit 2009 të mjekut Alexander Stefanidis, i cili ka trajtuar ndërshimet anatomike dhe funksionale të ventrikulit të majtë gjatë plakjes të të rriturit me diabet të tipit 2.

Pra, pacientët e vitit 2009 të spitalit grek i kemi marrë dhe i kemi sjellë në 2018 në Durrës, duke dalë me të njëjtat përfundime.

Në kapitullin 2, materialet dhe metodat, zonja ministre ka ndryshuar vetëm vitin e studimit dhe numrat e pacientëve të marrë për analizë, ndërsa metoda është e marrë nga ajo që ka shkruar mjeku grek Alexander Stefanidis.

“Në çdo vend të Europës plagjiatura është mashtrim, vepër penale, dhe në Shqipëri personazhe të tillë jo vetëm që duhet të kishin dhënë dorëheqjen dhe të ishin larguar nga jeta publike, por duhet të ishin marrë masat që këtyre personave t’u ishin hequr titujt, të kishin kthyer paratë që kanë marrë për shkak të këtyre titujve dhe të ishin krijuar të gjitha rregullimet ligjore apo legjislative që këto fenomene të parandaloheshin”, përfundon studiuesi Muka./*piranjat news*

Të gjitha të drejtat e këtij materiali janë pronë ekskluzive dhe e patjetërsueshme e Piranjat.al sipas ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Ndalohet kategorikisht kopjimi, publikimi, shpërndarja, jetërsimi pa autorizimin e Piranjat.al në të kundërt çdo shkelës do të mbajë përgjegjësi



Artikuj te sugjeruar

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimagias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

INVESTIGIME 31 Maj13:33

[Gratteri për Piranjat: Mafia shqiptare ortake me Ndrangheta kalabreze](#)

Në intervistën për Piranjat, Nicola Gratteri paralajmëron se mafia shqiptare po forcon pozitat e saj në Europë, veçanë...

INVESTIGIME 31 Maj13:12

[Gratteri për Piranjat: Kullat në Tiranë tregues i riciklimit](#)

Kryeprokurori italian i antimagias, Nicola Gratteri, në një intervistë ekskluzive për Piranjat, ngre dyshime të forta mbi burimin e i...

INVESTIGIME 31 Maj10:50

[Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët](#)

Prej tre javësh Piranjat kanë sjellë rrëfime e 4 nënave nga qyteti i Durrësit të cilat të alarmuara kërkonin kthimi...

INVESTIGIME 31 Maj10:26

[Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?](#)

Një javë më parë “Piranjat” publikuan historinë e 54-vjeçarit dibran, Fatmir Lakushi, i cili në vitin...

INVESTIGIME 31 Maj10:05

[Pallatet u zhytën“Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit](#)

Skandali i zhytjes së pallateve në projektin "Durrës Marina" po thellohet çdo ditë e më shumë. Pas publikimit...

INVESTIGIME 31 Maj09:46

[Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë](#)

Bumi i ndërtimeve dhe ngritja e pandalshme e kullave në Tiranë kanë ngritur prej kohësh pikëpyetje mbi burimin e financimeve dhe...

INVESTIGIME 30 Maj22:44

[Gruaja me dy identitete që premtonte "shërim" me ujë e kufomave në Pejë](#)

Magjistarët kanë ekzistuar gjithmonë, e një e tillë është edhe një grua me dy identitete, që po bën "m...

INVESTIGIME 30 Maj22:32

[Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët](#)

Prej tre javësh Piranjat kanë sjellë rrëfimn e 4 nënave nga qyteti i Durrësit të cilat të alarmuara kërkonin kthi...

INVESTIGIME 30 Maj22:12

[Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyrë" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?!](#)

Një javë më parë "Piranjat" publikuan historinë e 54-vjeçarit dibran, Fatmir Lakushi, i cili në vitin 2004 bl...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la" ...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 17 Shtator

[Tmerri i incestit/ Nëna 46-vjeçare pranon se ka...](#)

Një nënë e martuar dhe djali i saj janë akuzuar për incest, pasi ajo pranoi se të dy kishin kryer marrëdhënie seksuale &...

BOTA 18 Shtator

[Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...


INVESTIGIME 18 Shtator21:39

[TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të "Tigrave"](#)

Dy TEC-et lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3", të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qenë...

video





Liria nuk burgoset, as në Hagë, as në Beograd



Liria nuk burgoset, as në Hagë, as në Beograd





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.